



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 276, Datë 19.09.2023

MBI

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN GUSHT 2023 PËR KLIENTËT
E LIDHUR NË NIVELIN E TENSIONIT 35 KV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 87, pika 4 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 04.12.2017, e ndryshuar; dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.09.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2136/1 prot., datë 15.09.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin gusht 2023 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

- Me shkresën nr. 6251 prot., datë 07.09.2023, protokolluar me tonën me nr. 2136 prot., datë 11.09.2023, shoqëria Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., ka depozituar në ERE kërkesën për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin gusht 2023, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.
- ERE me shkresën nr. 2002/2 prot., datë 08.08.2023, solli sërish në vëmendje të FSHU sh.a. se në përlllogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët FMF, të lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, duhet të merren në konsideratë vetëm komponentët e njohur në nenin 6, pikat 3 dhe 5 si dhe neni 8 i “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 04.12.2017.
- FSHU sh.a. me shkresën nr. 5622/2 prot., datë 07.09.2023, protokolluar me tonën nr. 2002/4 prot., datë 11.09.2023, bëri me dije ndër të tjera se: “...Sipas Ligjit 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar (Neni 81), si dhe Rregullave të Tregut të Balancimit dhe akteve të tjera në fuqi, Furnizuesi është përgjegjës përballë Operatorit të Sistemit të Transmetimit për

çdo disbalancë të shkaktuar, kurse klientët janë përgjegjës përballë furnizuesit për disbalancat e shkaktuara. Nisur nga fakti që FMF e ka aktualisht teknikisht të pamundur për t'i përfshirë si zë më vete në faturën e energjisë elektrike kostot e disbalancave, pasi ky proces kërkon një modifikim të faturës aktuale të energjisë, këto kosto i shtohen çmimit të miratuar nga ERE për këtë kategori klientësh, dhe reflektohen në faturë në zërin çmim i energjisë elektrike...FSHU sh.a. në rolin e FMF nëpërmjet aplikimeve të kryera, ka si qëllim informimin e Entit Rregullator të Energjisë, mbi përfshirjen në faturën e energjisë për këta klientë...”

- Ndërkohë, në kërkesën për miratimin e çmimit FMF për muajin gusht evidentohet se shoqëria është shprehur si vijon: ***“Duke qënë se sipas nenit 8 të "Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit" miratuar me vendimin nr.201 date 04.12.2017 te Bordit të ERE-s i ndryshuar, në çmimin e përlogaritur nuk parashikohen kostot e disbalancave kërkojmë reflektimin e kësaj kostoje në çmimin e muajit Gusht 2023.”***
- Referuar nenit 81, pika 4, gërma “b”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe neni 9, pika 2, gërma “f” të “Rregullave për kushtet e shërbimit të furnizimit nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit dhe kushtet kontraktore të furnizimit me energji elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 247, datë 11.12.2018, furnizuesi ka detyrimin të informojë klientët në faturën e konsumit të energjisë elektrike mbi çdo element përbërës të çmimit si dhe kostot përkatëse.
- Nisur nga korrespondenca e mëparshme lidhur me aplikimin e FSHU sh.a., vlerësojmë që shoqërisë t’i dërgohet në vijim shkresës sqaruese, në të cilën t’i kërkohet paraqitja e aplikimit për miratimin e çmimit FMF në përputhje të plotë me dispozitat e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” si dhe informacion mbi veprimet e ndërmarra deri më tani ose masat që parashikohen për informimin e klientit mbi përfshirjen në faturën e konsumit të energjisë elektrike edhe të kostove të disbalancave.
- Mbështetur në nenin 8 të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, komponentët që janë marrë në konsideratë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2023 janë: kostot administrative, tarifa e shërbimit të rrjetit të transmetimit, tarifa e shërbimit të rrjetit të shpërndarjes, si dhe kursi i këmbimit i përdorur për blerjen e energjisë elektrike në treg të parregulluar.
 - Në zbatim të vendimit nr. 325, datë 14.12.2022 të bordit të ERE-s, kostot administrative të përlogaritura për aktivitetin e furnizimit vijnë të mbeten në vlerën 1.06 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Maj 2022 – 31 Dhjetor 2024, e miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 72, datë 13.04.2022, është 0.85 lekë/kWh.
 - Tarifa e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike në nivel tensioni 35 kV, në zbatim të vendimit të bordit të ERE nr. 324, datë 14.12.2022, vijon të jetë 1.55 lekë/kWh.

- Në zbatim të *Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit*, referuar aplikimit të FSHU sh.a. si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin gusht 2023, përllogaritet si më poshtë:

<i>Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin gusht 2023</i>		
	Njësia	Çmimi
CBEt ruar i blerjes së energjisë elektrike	Leke/kWh	11.98
Pr Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Leke/kWh	0.36
CA Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Leke/kWh	1.06
TRr Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Leke/kWh	0.85
TSHt Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Leke/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt +Pr* CBEt+ TRr+TSHt+CA	Leke/kWh	15.80

- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:
 - Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit do të jetë *15.80 Lekë/kWh për muajin gusht 2023*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

- Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit sh.a., për muajin gusht 2023, prej 15.80 Lekë/kWh për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.
- Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI